



Datë: 20.01.2023

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo Qeveritare në Komunën e Fushë-Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës u bënë thirrje të gjitha organizatave jo qeveritare të Regjistruara në divizionin e OJQ-ve që veprimtarit e tyre i zhvillojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për fazën e I-rë 2023.

Buxheti i mbështetjes financiare për OJQ dhe personat fizik është **70,000.00 €**, nga kategoria e subvencioneve për projekte.

Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500,00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 10,000.00€.

1. Organizatave Jo Qeveritare dhe persona fizik (indivind) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e kulturës, rinisë dhe sportit në këto lëmi:
 - 1.1 **Kulturë:** Trashëgimi kulturore (promovimi dhe interpretimi i trashëgimisë kulturore; edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, angazhimi i komunitetit, promovimi i diversitetit kulturor).
Botime të librave;
Art vizual (fuqizimi i artistëve të rinj, instalime në hapësira publike, ekspozitë);
Manifestime (shënimi i datave historike; shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave tjera me rëndësi në Komunën e Fushë-Kosovës)
 - 1.2 **Rini:** promovimi i vullnetarizmit, integrim i grupeve Rinore dhe atyre të marginalizuara dhe fuqizimi i organizatave Rinore (seminare, trajnime dhe kurse);
 - 1.3 **Sport:** masivizimi i sportit, përkrahje financiare e klubeve sportive, ngritje e nivelit profesional të klubeve sportive, aktivitete edukative me simpatizant me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit.
2. Organizatat Jo Qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes;
Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një muaj dhe maksimumi 4 muaj.
Organizatat jo qeveritare duhet po ashtu të kenë të kryer transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;

3. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë Organizatat Jo Qeveritare, që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Jo Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike dhe individët.
4. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në web-faqen e komunës linku www.komunaefushekosoves-rks.org , ndërsa thirrjet për sqarime dhe çështje tjera që lidhen me aplikimin mund të bëhen vetëm në mënyrën elektronike në e-mail adresën fatlum.berisha@rks-gov.net .

Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është pesëmbëdhjetë ditë dhe fillon nga data: 20.01.2023 dhe përfundon me datën: 10.02.2023

Vërejtje: Organizatat Jo Qeveritare dhe individët, përfitues të mbështetjes financiare, obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshminë e faturave të rregullta me kupon fiskal, dëshmitë e pagesave të pagave dhe kontributeve, 15 ditë pas përfundimit të projektit.

Sqarim: OJQ-të dhe individët, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Fushë Kosovës në këtë thirrje

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike:

Për individë:

- Kopjen e letërnjoftimit
- Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare)
- Formulari i projekt-propozimit
- Formulari i propozim buxhetit

Për botim libri:

- Formulari;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Biografia e autorit;
- Recensionit ;
- Një pjesë e veprës që do të botohet;
- Marrëveshja e nënshkruar me shtëpinë botuese ose pro fatura;
- Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare)

Për OJQ:

- Formulari i projekt-propozimit (për aplikacionin online)
- Formulari i propozim buxhetit (për aplikacionin online)
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar në formatin PDF)
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal (e skanuar në formatin PDF)

- Konfirmimi dhe pasqyra e llogarisë bankare së paku 1 vit (e skanuar në formatin PDF- nuk pranohet kopja e kartelës bankare)
- Vërtetimi i Administratës Tatimore.

Sqarim shtesë : Të gjitha dokumentet e cekura më lartë duhet të jenë në dy kopje fizike. Aplikacionet mund të dorëzohen në Zyrën Pritëse, si dhe me anë të postës, në adresën:

Fushë Kosovë, 12000, Rr. Tahir Zemaj, objekti i Komunës, departamenti i DKRS-së

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarfin e mbyllur gjithashtu në USB e cila duhet të jetë brenda zarfit.

Formularët duhet të plotësohen me anë të kompjuterit.

Ana e jashtme e zarfit duhet ta përmbaj:

- Emrin e thirrjes publike,
- Emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit
- Emrin e plotë të projektit
- Mbishkrimin "Mos e hap para hapjes zyrtare".

**Kryetari i Komunës
Burim Berisha**

